

VENDIM
Nr. 497, datë 22.7.2014

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 394, DATË 10.4.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE KONTRAKTUESE, PËRKATËSISHT, MINISTRINË E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE DHE MINISTRINË E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË NDËRTIMIT TË LANDFILLIT PËR TRAJTIMIN E MBETJEVE TË QARKUT TË DURRËSIT DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË “ALBANIA LANDFILL ENERGY” A.L.E.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 48, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 394, datë 10.4.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në titullin e vendimit dhe kudo në përmbajtje të tij, emërtesat “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” dhe “Ministria e Punëve Publike dhe Transportit” zëvendësohen, përkatësisht, me emërtesat “Ministria e Mjedisit” dhe “Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Koncesioni të jetë i formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim).”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama